# Raporti
## i takimeve me qytetarë

**Kryetari i Komunës së Rahovecit**
Municipal Mayor of Rahovec

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 4414 Nr. i faq/Br.str/No.pg 145
Data/Datum/Date 05/ 7 / 24
RAHOVEC / ORAHOVAC

| | |
|---|---|
| Data: | 05 korrik 2024 |
| Nga: | Kabineti i Kryetarit |
| Për: | z. Smajl Latifi, kryetar i Komunës së Rahovecit |

## Gjatë këtij viti janë realizuar gjithsej 57 takime me qytetarë.



Me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, si dhe qëndrimit afër nevojave dhe kërkesave të qytetarëve, Kryetari në zyrën e tij çdo të enjte ka pritur qytetarë për të dëgjuar kërkesat dhe shqetësimet e tyre.

Shqetësimet e ngritura nga palët kanë qenë kryesisht në infrastrukturë publike, si: rregullim i rrugëve, ndriçim publik, kanalizim, çështje pronësore, kërkesa për ndihmë momentale për persona me probleme shëndetësore, ndihmë në strehim dhe të tjera.

Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale përmes subvencioneve kanë ndihmuar vazhdimisht qytetarët në ndihma momentale, qoftë përmes subvencionimit direkt, qoftë edhe përmes ndihmës në furnizim me ushqim dhe material ndërtimor.

Po ashtu, Drejtoria e Shërbimeve Publike përmes projekteve kapitale ka realizuar rregullimin e ndriçimit publik në vendbanimet e Komunës së Rahovecit, si dhe në bashkëpunim me KRU "Gjakova" përmes marrëveshjeve që ka Komuna, ka bërë furnizimin me ujë dhe rregullimin e sistemeve të ujësjellësit aty ku ka pasur nevojë.

**Në këtë tabelë janë paraqitur numri i takimeve për secilin muaj dhe numri i qytetarëve:**

| Nr. | Muaji | Numri i takimeve |
|---|---|---|
| 1. | Janar | 14 |
| 2. | Shkurt | 18 |
| 3. | Mars | 03 |
| 4. | Prill | 06 |
| 5. | Maj | 11 |
| 6. | Qershor | 05 |
| | **Gjithsej** | **57** |

